



Npi – 01/441 datë: 27.11.2023

Duke u bazuar në nenin 43 dhe 49 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, Nr. 03/L-040, si dhe në bazë të nenit 3.13 të Rregullores së Punës së Kuvendit dhe Komiteteve, Npi – 01/114 të datës: 26.04.2019, për mbledhjen e Kuvendit të Komunës, të mbajtur më: 27.11.2023, është nxjerrë ky:

E K S T R A K T
PROCESVERBAL

I VAZHDIMIT TË DYTË TË MBLEDHJES SË -VIII- TË RREGULLT TË KUVENDIT TË
KOMUNËS SË SHITES

E thirrur për datën: 27.11.2023, (e hënë) në ora 09.⁰⁰ h. në sallën e Kuvendit.

Në mbledhje kanë marrë pjesë, Kryesuesi i Kuvendit: z.Adnan Ademi, Anëtarët e Kuvendit: z.Besnik Seferi, z.Gëzim Haxhiu, z.Asllan Beqaj, znj.Shkurte Mustafa, znj.Saniye Sadiki, znj.Zejnije Velu, z.Kadri Emini, znj.Rrezartë Ramadani, z.Muhamet Ademaj, z.Artan Lubovci, z.Përparim Ramusa, znj.Adelina Beqaj, znj.Albana Podvorica, znj.Besartë Musliu-Spahija, z.Rrahman Jakupi, z.Lumni Amrushi, z.Hasan Avdyli, z.Hamëz Tërshani, z.Reshat Mujota, dhe z.Rexhep Gashi.

Në mbledhje përveç anëtarëve të Kuvendit kanë marrë pjesë edhe: Kryetari, z.Qemajl Aliu, Drejtorët, Shefja e Kabinetit, znj.Anita Kurti, Përgjegjëse e ZKF-së znj.Kimete Ukaj, RZSH, Muhamet Hoxha, Asistente e Kryesuesit, znj.Gentiana Mehmeti, Zyrtarët e IT-së, Zyrtare e Informimit, znj.Vlora Hyseni dhe praktikantët, znj.Valmira Hoxha, znj.Sadbere Halili dhe znj.Donjeta Qorrolli.

Mbledhjen e hapi Kryesuesi i Kuvendit, z.Adnan Ademi, i cili pasi përshëndeti të gjithë të pranishmit Konstattoj, Kuorumin e mjaftueshëm për mbajtjen e mbledhjes së Kuvendit. Për këtë mbledhje kemi propozuar këtë:

REND DITE

1. Shqyrtimi i Ekstrakt Procesverbaleve nga mbledhjet e mbajtura më: 30.03.2023, 27.04.2023, 27.06.2023, 06.07.2023, 31.08.2023, 22.09.2023, 06.09.2023, 12.09.2023, 27.09.2023, 29.09.2023, 09.10.2023, 20.10.2023 dhe 03.11.2023.
2. Propozim-Vendim për Normat Tatimore për vitin 2024,
3. Raporti 9 mujor Buxhetor i Komunës së Shtimes për Janar-Shtator 2023,
4. Raporti i Auditimit të Jashtëm të Komunës së Shtimes për vitin financiar 2022,
5. Raportim për zbatimin e rekomandimeve të Auditimit të jashtëm për vitin 2022,
6. Diskutim për raportin vjetor të Auditorit të Brendshëm lidhur me Auditimet dhe Aktivitetet e kryera gjatë vitit 2022,
7. Propozim-Vendim për ndryshimin e vendimit të Kuvendit Npi-01/271 dt.06.07.2023 për Programin e banimit social 2023-2025 (Sipas rekomandimit të MMPHI Nr.3808-2/23 më datë: 18.07.2023).
8. Propozim – Vendim për zgjedhjen e dy anëtarëve të Komisionit nga Kuvendi për zgjedhjen e drejtorëve të institucioneve arsimore,
9. Draft-Rregullore për përcaktimin e procedurave për dhënien në shfrytëzim më pak se një vitë të pronës Komunale (Për diskutim publik),
10. Draft-Rregullore për Procedurat dhe Kriteret për zgjedhjen e Lauratëve të vitit në sport, (Diskutim Publik)

11. Draft-Strategjia e zhvillimit ekonomik të Komunës së Shtimes, Diskutim Publik)
12. Formimi i Grupit punues për hartimin e Planit të punës dhe orarit të mbledhjeve të Kuvendit për vitin 2024,
13. Propozim-Vendim për ndryshimin e vendimit të Kuvendit Npi-01/54 dt. 28.03.2022, për plotësimin e KPF me anëtarë të ri,
14. Propozim-Vendim për ndryshimin e vendimit të Kuvendit Npi – 01/139 dt. 31.05.2022, për plotësimin e KASHPU me anëtarë të ri,
15. Propozim-Vendim për ndryshimin e vendimit Npi-01-149 dt. 27.04.2023 të Komis. të Aksionarëve të KRM 'Pastërtia' Njësia në Shtime,
16. **Propozim-Vendim për faljen e 100 euro për Tatim-paguesit e komunës së Shtimes për vitin 2023. (Pikë Shtesë)**

Kryesuesi i Kuvendit, z.Adnan Ademi; Hapi diskutimin për rendin e ditës.

znj.Adelina Beqaj; Përshëndetje, edhe pse në këtë mbledhje e kemi volumin e madh të pikave të rendit të ditës, unë propozoj që edhe pika pyetje përgjigje të jetë pikë shtesë.

z.Reshat Mujota; Përshëndetje, fillimisht ju uroj të gjithëve festën e 28 nëntorit. Sa i përket pikave të rendit të ditës ne e kemi pas një ftesë dhe dhe i kemi votuar njëherë pikat e rendit të ditës, ne mund të shtojmë pika por jo me hjekë pika të rendit të ditës. Atëherë i kemi pas 11 pika të cilat janë miratuar me 12 vota "Për". Unë nuk them të hiqen pikat por të shtohet edhe pika "Pyetje përgjigje".

z.Hamëz Tërshani; Përshëndetje, pajtohem me propozimet, është problem që ka shumë pika por, 4 pika shkojnë në diskutim publik.

z.Përparim Ramusa; Përshëndetje, parafolësit i potencuan vërejtjet për vazhdimin e mbledhjes. Ne kemi filluar dhe e kemi votuar rendin e ditës. Mendojë me e votuar edhe pikën shtesë për faljen e 100 euro për tatimpagesit e komunës së Shtimes, e pyes zyrtarin ligjor nëse e merr përsipër aspektin ligjor.

z.Rexhep Gashi; Përshëndetje, e kemi një ftesë për vazhdimin e mbledhjes. Përpara edhe VV-ja edhe LB-ja ka qenë për me e futë si pikë edhe pikën "Pyetje Përgjigje", një periudhë nuk kemi mundur me mbajtë mbledhje, mirëpo unë mendoj se duhet me vazhdu me pyetje përgjigje.

z.Besnik Seferi; Përshëndetje, sa i përket propozimit për pikë shtesë "Pyetje Përgjigje", KPF-ja ka rekomanduar që me futë si pikë shtesë vetëm, faljen e 100 euro për tatimpagesit, nuk mundë t'i fusim dy pika shtesë sipas rregullores edhe pse ka nevojë, por do t'i fusim në mbledhjen e ardhëshme, ne jemi për rendin e ditës ashtu siç ka ardhur.

znj.Adelina Beqaj; Pika "Pyetje përgjigje" është me automatizëm pa marrë parasysh volumin e madh të pikëve.

z.Reshat Mujota; Nuk e di a jemi duke e vazhduar mbledhjen apo kjo është mbledhje e re. E kemi një rekomandim nga Besim Murtezani – MAPL-ë për me shty mbledhjen dhe e ke shty mbledhjen ti Kryesues.

z.Përparim Ramusa; Në emër të grupit parlamentar të PDK-së, replikë ndaj Besnikut, në KPF nuk kemi pik të rendit të ditës "Pyetje përgjigje" kemi pika më primare siq është falja e 100 eurove për tatimpagesit të cilën mundemi me e futë si pikë shtesë.

z.Rexhep Gashi; Nuk ka dilemë se a të vazhdohet me pika të njejta apo me pika e reja. Unë kërkoj nga zyrtari ligjor të na jap sqarime.

z.Kadri Emini; Përshëndetje, siç e dini i kemi 2-3 mbledhje që kanë dështuar, dhe tani rrethanat kanë ndryshuar shumë, unë nuk e shohë të arsyeshme mos me punu me këtë rend dite. Ky rend i ditës të miratohet, ndërsa sa i përket pikës "Pyetje përgjigje" jemi dakorduar që mos me u fut si pikë për shkak të volumit të madh të pikave.

z.Hamëz Tërshani; U pajtova me propozimin, por unë nuk pajtohem me Kadriun, sepse nëse pajtohem për mos me u fut si pikë e rendit të ditës "Pyetje përgjigje", atëherë është shkelje e rregullores.

Kryesuesi i Kuvendit, z.Adnan Ademi; E kuptoj mirë sencën e 27 Gushtit, dhe më pastaj kanë ndodhur edhe disa mbledhje të jashtëzakonshme. Unë jamë konsultuar me zyrtarët e Ministrisë, kjo

seancë është në kushte jo normale, sepse i kemi futur 4 seanca në një seancë të vetme, prandaj duhet ta keni mirkuptimin për këtë seancë. Kuvendi është ai që vendos për rendin e ditës.

Kryesuesi i Kuvendit, z.Adnan Ademi; Konstatoi Kuorumin prej 21 anëtarëve të Kuvendit prezent.

***Kuvendi i Komunës së Shtimes, me 11 vota “Për” me 10 vota “Kundër” dhe me 0 vota “Abstënim” miratoi rendin e ditës me pikën e 16 shtesë, “ Propozim-Vendim për faljen e 100 euro për Tatim-paguesit e komunës së Shtimes për vitin 2023”.**

Pika 1

Shqyrtimi i Ekstrakt Procesverbaleve nga mbledhjet e mbajtura më: 30.03.2023, 27.04.2023, 27.06.2023, 06.07.2023, 31.08.2023, 22.09.2023, 06.09.2023, 12.09.2023, 27.09.2023, 29.09.2023, 09.10.2023, 20.10.2023 dhe 03.11.2023.

Kryesuesi i Kuvendit, z.Adnan Ademi; Hapi diskutimin për këtë pikë.

z.Reshat Mujota; Sa i përket procesverbaleve, ne kemi kërkuar që të shtohet numri i zyrtarëve në sekretari. Kamë shqetësime që diskutimet nuk janë të përfshira në procesverbale. Ju lusë që për çdo mbledhje të sillen procesverbalet për miratim, sepse kështu nuk mund të votohen, unë do të abstenojë sepse nuk e kanë efektin e duhur 11 procesverbale.

znj.Adelina Beqaj; Numri i procesverbaleve është shumë voluminoz, por forca e numrave e bën të vetën sepse e kanë votuar edhe buxhetin.

z.Hamëz Tërshani; Kamë një pyetje, cili është roli i këtyre vazjave, a ka mundësi që këto me qenë më të qeta dhe mos me komentu për secilin që flet.

z.Rexhep Gashi; Para kësaj mbledhje kamë thënë se Kuvendi po shëndrrohet në cirkus. Shprehja “jo normale” nga Kryesuesi nuk bënë të përdoret, sepse kemi 11 procesverbale, dhe prap po ndodhin shkelje në privatësi, e kanë fuqinë e votës dhe shëndrrohet në mbledhje jo të rregullt. Në procesverbalin e fundit nuk mu ka përfshi 20% e diskutimit. Sekretaria e ka neglizhuar pikërisht diskutimin e asambleistëve.

Kryesuesi i Kuvendit, z.Adnan Ademi; Konstatoj Kuorumin prej 20 anëtarëve prezent në mbledhje.

Kuvendi i Komunës së Shtimes, me 11 vota “Për” me 3 vota “Kundër” dhe me 6 votë “Abstënim” miratoi, Ekstrakt Procesverbalet nga mbledhjet e mbajtura më: 30.03.2023, 27.04.2023, 27.06.2023, 06.07.2023, 31.08.2023, 22.09.2023, 06.09.2023, 12.09.2023, 27.09.2023, 29.09.2023, 09.10.2023, 20.10.2023 dhe 03.11.2023.

Pika 2

Propozim-Vendim për Normat Tatimore për vitin 2024

Kryesuesi i Kuvendit, z.Adnan Ademi; Fjalën ia dha Kimete Ukaj.

znj.Kimete Ukaj, ZKF; Pasi përshëndeti të gjithë të pranishmit tha se dokumentin e keni marrë me kohë dhe besoj e keni lexuar prandaj unë nuk do ta zgjati shumë, vetëm nës e ka ndonjë pyetje unë do të përgjigjem, (shih dokumentin).

z.Bujar Ferati, Përgjegjës i zyrës tatimore; Përshëndetje, Me ligjin e ri nuk kemi më Rregullore por vetëm Vendim për Normat Tatimore, e të cilat janë të parapara me shkallë progresive. Për normat tatimore prej 3.1 deri në 3.5. Më parë e kemi pas vlerësimin 0.15, tani e kemi 0.10 vlerën tatimore në minimum.

z.Kadri Emini; Në KPF e kemi pas të paqartë se kush e bën vlerësimin.

z.Bujar Ferati; Komisioni i Departamentit që caktohet nga Ministria e Financave e bënë vlerësimin.

z.Hamëz Tërshani; Nga KPF-ja e kemi një rekomandim. Uroj për Kimetin kthimin në ZKF. Unë po kërkojë përqindjen minimale të normave tatimore për shkak të gjendjes që e kemi të qytetarëve.

z.Rexhep Gashi; E falënderoj Bujarin për dokumentin, vlerat janë shumë të mëdhaja dhe tatimi do të jetë shumë i madh. A kemi mundësi me intervenuar te vlerat?

z.Përparim Ramusa; Faleminderit për sqarimet edhe në KPF. Me ligjin e ri e kemi Kuvendin me i caktu normat tatimore, i përmendi vlerat tatimore nga 100 mijë euro deri në 1 milion, unë propozoj që të shkojmë në minimum.

z.Bujar Ferati; Për normat tatimore e keni obligim me marrë vendim, por çmimet nuk mundeni me i caktu. Këto norma janë të rëndësishme për caktimin e vlerës tatimore.

z.Reshat Mujota; Faleminderit për sqarimet, pajtojë që normat tatimore të jenë minimale, duke e pasur parasysh gjendjen e banorëve të Komunës së Shtimes. Nëse zbriten atëherë le të zbriten te banesat rezidenciale, nëse shkojmë në minimum atëherë nuk kemi nevojë me vendos për faljen e 100 eurove te tatimpaguesve.

z.Bujar Ferati; Po jap sqarim, shumicën e thash tani nuk është më kështu, sepse siç e thash me ligjin e ri i kemi normat progresive, që e ka qëllimin për tatim paguesit që ka pronë me vlerë më të lartë edhe do të paguaj më shumë. Shumica e tatim paguesëve është te vlera e këtij 100.000 euroshit.

z.Muhamet Ademaj; Faleminderit për fjalën. Ne si grup i subjekteve LDK-AKR i përkrahim normat tatimore 2024.

z.Lumni Amrushi; Përshëndetje, po besojë që jemi të gjithë njëzërit që të shkojmë me normat minimale tatimore.

z.Bujar Ferati; Ne i tham vlerat që i kemi në dokument. Vlerat e larta shkojnë në mënyrë progresive. **Kryesuesi i Kuvendit, z.Adnan Ademi;** Konstatoj Kuorumin prej 21 anëtarëve prezent në mbledhje.

***Kuvendi i Komunës së Shtimes unanimisht miratoi, Normat Tatimore për vitin 2024 në Komunën e Shtimes.**

Pika 3

Raporti 9 mujor Buxhetor i Komunës së Shtimes për Janar-Shtator 2023

Kryesuesi i Kuvendit, z.Adnan Ademi; Fjalën ia dha Kimete Ukaj.

z.Kimete Ukaj, ZKF; Me ligj e kemi obligim që në Kuvend ta paraqesim raportin 9 mujor buxhetor. Në vazhdim do të lexoj shpenzimet e përfshira nëpër kodet buxhetore (shih dokumentin).

z.Muhamet Ademaj; Ky raport ofron informata të mjaftueshme. Për raportin 9 mujor duhet të shpenzohen reth 70% ndërsa i kemi shpenzuar 64% lajmi i mirë është se kemi rritje të të hyrave nga tatimi. Ne e përkrahim raportin 9 mujor.

z.Hamëz Tërshani; Po pajtohem me parafolësin për raportin, kamë një pyetje për një kontratë që ka nënshkruar Komuna me AZHR-në. Ku janë marrë paret për këtë kontratë? Edhe një kontratë për angazhimin e konsulentëve të ri. Kush janë këta konsulentë? Qysh është e mundur mos me ditë Komuna kush janë këta konsulentët, dyshimet janë që janë angazhuar militantë të LDK-së dhe LVV-së. Unë i di emrat edhe ju i dini por po du me ditë edhe qytetarët. Këtu ka edhe elemente të veprës penale.

z.Kastriot Shabani, DZHE; Këto marrëveshje kanë të bëjnë edhe me drejtorinë time. Rekrutimin e kandidatëve e bëjnë organizata e jo ne, memorandumin e bëjmë dhe nënshkruajmë ne si Komunë. Ngrohtorja si projekt i madhë nuk mundet me qitë e me marrë informata njerëzit pa kualifikim e pa përvojë, kush ka fitu në këtë konkurs e ka vlerësu vetë organizata, dhe është po kjo organizatë e cila ka qenë edhe më herët po flasë për pushtetin e kaluar.

z.Hamëz Tërshani; Qysh i gjeti AZHR-ja Ruzhdi Jasharin, Egzon Selmanin dhe disa të tjerë militantë për me i rekrutuar.

z.Kastriot Shabani, DZHE; Cilët janë ata persona që kanë aplikuar e që nuk i kanë pranuar?

z.Përparim Ramusa; Diskutimi paraprak është në kuadër të pikës. Pajtohem me Hamzën, por i keni gjetë 5 militanta dhe u keni dhënë pare me pi kafe nëpër Shtime. Sa i përket shpenzimeve 9.1 milion për paga i keni shpenzuar 86%, ndërsa tek mallrat dhe shërbimet i keni shpenzuar 56%. Te shpenzimet kapitale i keni shpenzuar vetëm 45%, në shëndetësi nuk i keni shpenzuar 115 mijë euro ndërsa atje nuk ka as qarshafa. Te arsimi fotokopjuesit nuk ju bëjnë, dyert e dritaret janë të prishta ndërkaq që i keni të pa shpenzuar edhe mbi 100.000 euro. Te zyra e Kryetarit i keni 76%. Kamë një pyetje se çka ka ndodhë me shujtat e nxënësëve? Pse mos me u përmbushë zotimi yt për këtë pikë.

Kryetari, z.Qemaj Aliu; Përshëndetje, u ngriten shumë çështje, që për brenda e kanë më shumë dezinformimin si qëllim se sa që pasqyron diçka reale. Në 3 mujorin e dytë fillohet me zhvillimin e projekteve. Tjerat projekte fillojnë në Qershorë ato që e kanë fatin e keq shkojnë në OSHP. Ne do

të presim ta mbyllim vitin fiskal dhe pastaj të diskutojmë. Vitin e kaluar buxheti ka qenë i miratuar nga qeverisja e kaluar mirpo ne kemi arritur 76% e që ju nuk keni arritur për 20 vite. Arsimin dhe shëndetësin i kemi prioritet edhe në vepër. Këtë vitë i kemi ndarë 130 mijë euro për barna nga 30 mijë sa kanë qenë më herët, ky është prioriteti ynë. Në arsimin e kemi prioritet, siq po e shihni që kanë ndodhur renovimet në shkolla pastaj po i bëjmë edhe 2 çerdhe të reja. Kemi 450 mijë euro më shumë të ndara për arsim që po i investojmë. I kemi edhe 3 muaj të raportit përfundimtarë. Ky është raport 9 mujor. Kontrata një burimore janë politika të juaja. Tash në Komunën e Shtimes kontrata një burimore nuk ka më. Këtë fakt e thotë edhe rezultati i auditorit të jashtëm që është i vlersuar si “pakualifikuar”. E kemi fituar grandin e performancës dhe me këtë i marrim bonus 700-800 mijë euro për Komunën tonë.

z.Përparim Ramusa; Replikë, nuk është etike dhe e moralshme me përcaktu zërin e kuvendarit a është i hollë apo i trashë. Unë i referohem raportit të juaj të prioritetëve. Kryetari shkon prej Fushë Kosovës dhe e bjen një drejtor në DSHMS, e ka prurë një person të komunitetit që nuk janë kundër, por të ishte nga Komuna jonë. Kryetari tha me pritë deri në raportin vjetor, qysh mujnë me prit nxënësit për marrjen e një shujte?

znj.Adelina Beqaj; Nëse flasim për dezinformim prej fillimit deri më tash Kryetari foli dezinformata nëse e ke prioritet arsimin atëherë prioritetet janë sigurimi i printerave.

z.Hamëz Tërshani; Diskutimet e Kryetarit janë të përgjithëshme kemi qenë përfitues të grandit të performancës disa herë. Nuk jamë i kënaqur me përgjigjen e Kastriotit kontratat me AZHR-në janë nënshkruar me Kryetarin. Pyetje është a janë zhvilluar procedurat konform ligjit?

z.Besnik Seferi; Përhëndetje, te projektet kapitale nuk është arritur një 76% i dëshiruar por nuk bënë me ardhë në atë pikë që çdo gjë e mirë të thuhet dhe paraqitet keq. Nuk i kuptoj këta të PDK-së kur ne ishim në pushtetin e kaluar dhe gjithëmonë janë ankuar për shkakë të procedurave dhe është gjetë ndonjë arsyetim. I rekomanoj Kuvendit që të mirret me më shumë intenzitet edhe pse është marrë. Ti bashkojmë për punë të mira ne si LVV jemi për aprovimin e raportit.

z.Lumni Amrush; Më nxit fjalimi i Besnikut e mbajë mend se çka ka bërë ky edhe për një fletë të bardhë e leje më për printer që mungon në shkolla. Nëse keni pritë me bërë asfalt nëpër borë tani e keni mundësinë sepse ka ra borë.

z.Besnik Seferi; Replikë, e di fortë mirë qka kamë thënë atëherë. Tani kemi një shumë marramendëse të investimeve e të thuhet është katastrofë dhe të thuhet se nuk duhet të votohet, unë them se është puro politike.

z.Rexhep Gashi; Po diskutohen shumë gjëra, raporti është i Ekzekutivit i falenderojmë obliguesit që i kanë kryer punët e tyre. Ky raport në anën profesionale është në shtylla. Te shpenzimet nuk është për tu krenuar se sa janë shpenzuar. Faji tentohet të gjuhet dikun tjetër.

z.Bujar Ferati; Raporti 9 mujor ka qenë pjesë e imja e punës time vështërsi ka pasë te lidhja e kontratave, mbyllja e tyre e të tjera. Ky raport lidhet edhe me me raportin e auditorit të jashtëm ku janë paraqitur nga raporti i tijë. Edhe pjesa e azhuritit nuk varet krejt nga ekzekutivi dhe angazhimet e tijë.

z.Reshat Mujota; Ka shpenzime, ka që nuk është punu, ka premtime, probleme psh te arsimit nuk është çdo gjë në rregull. Keqpërdorime ka psh te arsimit printerat jo që janë prishur por nuk ka fare, kemi pasë një drejtorë nga Kaçaniku, kurrë asnjë falenderim nuk e ka bërë për qytetarët. Ky është keqpërdorim, te Drejtoria e Inovacionit pagat hargjohen e nuk kemi rezultate. Te investimet kapitale, u punu te shkolla profesionale mu rregullu banjot shkojë gysmëvjetori me disa lyroje. Kemi probleme me nxemjet, e kemi këtu profesorin që nuk i ngritë këto çështje. Te arsimit shkolla e mesme i kemi nda 150 mijë euro. Nuk pashë në raport a janë shpenzuar. Asfaltet janë ka 3 metra që keni thënë nuk i shtrojmë. Mendojë që kot po shpenzojmë te sheshi pjesa te kockat kanë me u prishë brenda mandatit. Mbikqyrja për projektet nuk po del me i përcjellë punët. Unë do të abstenojë për shqetësimet e mija dhe nuk jamë i kënaqur me shpenzimet.

z.Rrahman Jakupi; Përhëndetje, u ngriten disa çështje por disa mbeten anash. Te arsimit si prioritet ne i kemi bërë disa analiza po e demonstroj pagesen e dy drejtorave që është keqpërdorim tipik. Ky pushtet po mbrohet duke thënë mos folni ju deri në janar. Kjo është vetëm një gjetje. Nuk kam koment, kualiteti është jashtëzakonisht i keq, ka keqpërdorime. Këta persona që janë përfshi me

AZHR-në nuk kanë as shkollën e mesme e ju i quani ekspertë. Keni shkel nenin 77 të ligjit për financa publike. Ku jeni bazuar për nënshkrimin e marrëveshjes me AZHR-në dhe qysh është e mundur me i pagu dy drejtorë.

z.Bujar Ferati; Përshëndetje, përmbajtja e raportit ka saktësi 100% disa çështje nuk menaxhohen nga Komuna janë pa raportim.Për ndryshimet njoftohet që bëhen njoftohet edhe sistemi Pejroll. Për sa i përket përgjegjësisë janë organet kompetente. Unë nuk besojë se janë paguar dy drejtorë por ka mundësi që ndryshimi është bërë me vonesë. Por ai i kthen mjetet, gabimet në kohë mund të ndodhin por dy persona nuk mundë të marrin pagë për vendin e njejtë të punës.

Kryetari, z.Qemaj Aliu; Zyrtari kryesor financiar e sqaroi mirë çështjen e pagesës së dy drejtorëve që nuk e lejon një gjë të tillë Pejrolli.

Kryesuesi i Kuvendit, z.Adnan Ademi; Ka mundësi me ndodhë gabimet teknike por nuk bënë me dezinformu sepse nuk ka mundësi me i marrë dy paga i njejtë person.

z.Besnik Seferi; ZKF-ja e sqaroi shumë mirë nëse ka argumente PDK-ja le të ngrit padi. Unë kam bërë edhe një mandatë. 76% është raporti, e që ka mbetë edhe pak dhe nuk ka mundësi me vjedhë ne jemi për miratim e këtij raporti.

z.Bujar Ferati; Jam i vetëdijshëm për atë që e kam punuar. Kam informatën që ka ndalesë për 250 euro për rastin që u potencua.

z.Rrahman Jakupi; Keqpërdorime këta bëjnë se mua nuk mundeni me më demantuar sepse keni me u përgjigjë penalisht.

Kryetari, z.Qemaj Aliu; Po sqarojë për fotokopjuesit se kontrata e mirëmbajtjes ka qenë kontratë qendrore e lidhur me operatorin ekonomik dhe u ndërpre për të gjitha Komunat, është ritenderuar, kështu ju kërkojë ndjesë të gjithë arsimtarëve, për sa i përket premtimeve të mija që janë 107 premtime jo që po i realizojë por po i shumëfishojë. 3 muaj me rradhë janë mbajtur peng investimet në shkolla, ka edhe të tillë që keni votuar “kundër”. Cila është e vërteta a te ju apo te ata në Kuvendin e Kosovës që e kallën duke thënë se po investohet shumë në Shtime cila qenka e vërteta.

Kryesuesi i Kuvendit, z.Adnan Ademi; Konstatoj Kuorumin prej 21 anëtarëve prezent në mbledhje.

*** Kuvendi i Komunës, me 11 vota “Për” me 80 vota “Kundër” dhe me 2 vota “Abstenim” miratoi, Raportin nëntë (9) mujor buxhetor të komunës së Shtimes për periudhën Janar-Shtator 2023.**

Kryesuesi i Kuvendit, z.Adnan Ademi; Tani është pauza e drekes ora 12 vazhdojmë në ora 13:00h.

Pika 4

Raporti i Auditimit të Jashtëm të Komunës së Shtimes për vitin financiar 2022

Kryesuesi i Kuvendit, z.Adnan Ademi; Fjalën ia dha Kimete Ukaj.

znj.Kimete Ukaj, ZKF; Raporti i auditimit është i pa modifikuar ose pa i kualifikuar qysh te doni quane. Nëse ka pyetje jam këtu për tu përgjigjur.

Kryesuesi i Kuvendit, z.Adnan Ademi; Lexojë rekomandim e KPF-së.

znj.Adelina Beqaj; I pash të gjeturat, mua po më intereson procedurat për IT për blerje të paisjeve nuk po shohë këtu asgjë urgjente. A ka mundësi me na sqaruar?

Kryesuesi i Kuvendit, z.Adnan Ademi; Lus drejtorin që të kthejë përgjigjen me shkrim.

z.Rexhep Gashi; Pikërisht gjatë raportit i kemi 12 rekomandime 6 te reja dhe 6 të përsëritura janë shqetësuese rekomandimet e përsëritura. Në vazhdim lexoi një pjesë të raportit të auditimit. Të gjeturat te tregu nuk është një çështje për ta tejkaluar. Sygjerohet që rekomandimet të përmirsohen.

z.Përparim Ramusa; Te raporti i auditimit siç e dijmë është i pavarur 6 me 6. Auditori nuk i auditon të gjitha kontratat. Te IT-ja është kontratë një burimore nuk ka pasë asgjë me urgjencë. Për një muaj kanë shkuar në 76%.

z.Muhamet Ademaj; Ky raport mundë të dëgjohet e diskutohet por nuk mundë të ndryshohet. Kërkojë që rekomandimet e auditorit ti zbatojë ekzekutivi.

z.Rrahman Jakupi; Për këtë raport vlen të ceket a ka vend për hetim në këtë raport. Kanë ble IT-ja llapropa për me i marrë në shtëpi me i keqpërdorë. Ne kemi hetuar keqmenaxhimin te subvencionet.

Kamë bërë analizë se ka keqpërdorim nga Kryetari të subvencionet. Te IT-ja qka është bërë me atë gjendje të auditorit që janë gjetë te IT-ja. Qështja e shtabit të Rancës 10 mijë euro, janë transferuar te objekti i tregut pa e pyetur Kuvendin. A ka keqpërdorim të shpenzimeve të mjeteve.

znj.Zejnije Veliu; Përsëritet, auditori ka dhënë një opinion të “pamodifikuar” ku do të thotë nuk janë gjetë keqpërdorime.

z.Rrahman Jakupi; Nuk më kupton, ne kemi krijuar një Komision që është i ligjshëm.

znj.Zejnije Veliu; Për atë Komision e ka dhënë mendimin vet.

z.Rrahman Jakupi; Auditori ka thënë se ka dobësi.

z.Reshat Mujota; Fakt është se raporti nuk ndryshohet më shqetësuese është për të gjeturat e përsëritura dhe kriteret që nuk janë respektuar gjatë prokurimit. Gabime mund të ketë por serioziteti duhet të jetë, pse i kemi 6 pika të përsëritura?

z.Bujar Ferati; Proceduralisht raporti është dashtë ardhë më herët por Kuvendi nuk ka funksionuar. Nuk kamë qka me diskutua më shumë ne krijojmë grupe punuese që i kryejnë të gjeturat. Ne i zbatojmë këto për mos me u përsërit dhe mos me pasë të gjetura.

Pika 5

Raportim për zbatimin e rekomandimeve të Auditimit të jashtëm për vitin 2022

Kryesuesi i Kuvendit, z.Adnan Ademi; Fjalën ia dha Kimete Ukaj.

znj. Kimete Ukaj, ZKF; Materialin e keni marrë dhe e keni lexuar. Por pavarësisht kësaj për zbatimin e kësaj ne duhet me raportuar në Kuvend, u tha se i kemi 12 të gjetura 6 me 6 (shih dokumentin), nëse ka ndonjë pyetje unë do të përgjigjem.

z.Përparim Ramusa; Faleminderit për sqarimet, këtu shihet që ekzekutivi nuk ka interes për zbatimin e rekomandimeve, për drejtorin e kanë dit kur del në pension, pse nuk janë marrë masat më herët për zëvendësim? Sa puna është këtu, drejtori i Auditimit e kanë ditë që shkonë në pension.

znj.Zejnije Veliu; Raporti i auditimit për vitin 2021 i ka 15 rekomandime 9 prej tyre janë të përsëritura. Këto 12 rekomandime për vitin 2022 janë 6 me 6 ku janë në zbatim e sipër.

z.Hamëz Tërshani; Faleminderit për raportin, këto furnizime me paisjet e IT-së për kënd është bërë blerja?

z.Bujar Ferati; Më herët e elaborova pak a shumë. Janë 18 anëtarë në komision që i prijë unë. Këto që janë në zbatim duhet me prit deri në fund të vitit. Dhe shënohet në raport ne i kemi përmirësuar 5 nga 12 edhe pse ende jemi pa përfunduar vitin, e që momentalisht jemi duke bërë auditim për vitin 2023 paisjet janë blerë për zyren tonë dhe nuk kamë çka me thënë. Nuk deklarojmë diqka që 100 % nuk është realizuar.

znj.Adelina Beqaj; Këtu 15 mijë euro kush ka blerë llaptopa?

z.Bujar Ferati; Është fjala për të gjeturat e auditorit. Besoj që deri në fund njësia kërkuese ose e prokurimit për pjesën në vazhdim drejtorja do ta sjellë në Kuvend.

Pika 6

Diskutim për raportin vjetor të Auditorit të Brendshëm lidhur me Auditimet dhe Aktivitetet e kryera gjatë vitit 2022

Kryesuesi i Kuvendit, z.Adnan Ademi; Fjalën ia dha Jetufsh Rrafshi.

z.Jetush Rrafshi; Përsëritet, qëllimi i këtij auditimi është për të pasqyruar një raport për aspektet e menaxhimit dhe të shpenzimeve nga ekzekutivi. Raporti përmban auditimet, të gjeturat që janë kryer. Janë kryer 6 auditime gjatë vitit 2022 për kontrollin e brendshëm të menaxhmentit (shih dokumentin).

z.Përparim Ramusa; Faleminderit për raportin prej Jetushit, e kuptojmë rolin e auditorit të brendshëm. Dy pagesa janë gjetur ku fillimisht është bërë pranimi e pastaj është lëshuar faktura pyetje për zotrin Rrafshin por nëse ka edhe zonja Veliu le të përgjigjet.

z.Jetush Rrafshi; Për rekomandimet e auditimit të jashtëm e diskuton menaxhmenti. Sigurisht që edhe auditori i brendshëm i ka parasysh edhe rekomandimet e auditimit të jashtëm. Menaxhmenti e bënë trajtimin e të gjeturave zakonisht për varet edhe nga gjetura.

Pika 7

Propozim-Vendim për ndryshimin e vendimit të Kuvendit Npi-01/271 dt.06.07.2023 për Programin e banimit social 2023-2025 (Sipas rekomandimit të MMPHI Nr.3808-2/23 më datë: 18.07.2023)

Kryesuesi i Kuvendit, z.Adnan Ademi; Hapi diskutimin për këtë pikë.

Kryesuesi i Kuvendit, z.Adnan Ademi; Konstatoj Kuorumin prej 17 anëtarëve prezent në mbledhje.

*** Kuvendi i Komunës së Shtimes, unanimisht miratoi, vendimin për korrixhimin e bazës Ligjore të Vendimit të Kuvendit të Komunës së Shtimes Npi-01/271, dt. 06.07.2023, për Programin e banimit social 2023-2025 (Sipas rekomandimit të MMPHI Nr.3808-2/23).**

Pika 8

Propozim – Vendim për zgjedhjen e dy anëtarëve të Komisionit nga Kuvendi për zgjedhjen e drejtorëve të institucioneve arsimore

Kryesuesi i Kuvendit, z.Adnan Ademi; Lexoi propozimin e DKA-së.

z.Reshat Mujota; Janë dy anëtarë të propozuar, ndoshta do të ishte më mirë që stafet e shkollave me vendosë për zgjedhjen e drejtorave të shkollave.

z.Besnik Seferi; Edhe une nashta isha pajtu me Reshatin, mirpo nëse i ndryshojmë kandidatët atëherë e shkelim U.A sepse ai i ka paraparë ashtu.

z.Reshat Mujota; Faleminderit Besnik, unë e thashë nga Kuvendi por mos të jetë politik, le të zgjedhen dy anëtarë të Kuvendit në rolin e vëzhguesit.

z.Përparim Ramusa; Te kjo pikë e kemi U.A dy anëtarë të propozuar nga DKA dhe nuk janë anëtarë të Kuvendit. Unë i kam emrat para vetit. Fatmiri le të kalon por Feride Qorrolli nuk po e njeh asnjë anëtarë i Kuendit. Unë jamë që këta dy emra të kalojnë.

z.Muhamet Ademaj; Edhe ne si LDK-AKR jemi për me kaluar Fatmiri e Feridja. Presim nga ky Komision që ti zgjedhin sipas meritokracisë.

znj.Zejnije Velju; Pajtohem me parafolësin Fatmirin e njohim, për Feriden kamë marrë informata. Ka të përfunduar masterin në matematikë dhe i plotëson krejt kushtet.

Kryesuesi i Kuvendit, z.Adnan Ademi; Konstatoj kuorumin prej 21 anëtarëve prezent në mbledhje.

*** Kuvendi i Komunës, me 19 vota “Për” me o vota “Kundër” dhe me 2 vota “Abstënim” miratoi Vendimin për formimin e Komisionit për vlerësimin e kandidatëve që kanë konkurruar në të gjitha Konkursët që do të shpallen nga DKA-ja për postin e drejtorit, përkatësisht zëvendës-drejtorit, në Institucionet edukativo-arsimore të komunës së Shtimes, me mandat një (1) vjeçar deri më 27.11.2024.**

Pika 9

Draft-Rregullore për përcaktimin e procedurave për dhënien në shfrytëzim më pak se një vit të pronës Komunale (Për diskutim publik)

Kryesuesi i Kuvendit, z.Adnan Ademi; Hapi diskutimin për këtë pikë.

Kryesuesi i Kuvendit, z.Adnan Ademi; Konstatoj kuorumin prej 21 anëtarëve prezent në mbledhje.

*** Kuvendi i Komunës, unanimisht miratoi vendimin për ta nxjerrë në diskutim publik, Draft-Rregulloren Komunale për përcaktimin e procedurave për dhënien në shfrytëzim pronën komunale për më pak se një vit, për afatin prej 15 ditësh. Bartëse e procesit të diskutimit publik është Drejtoria për Planifikim Urban, Kadastër dhe Gjeodezi, në bashkëpunim me Zyrën për Informim, dhe Komitetin për Politikë dhe Financa.**

Pika 10

Draft-Rregullore për Procedurat dhe Kriteret për zgjedhjen e Lauratëve të vitit në sport, (Diskutim Publik)

Kryesuesi i Kuvendit, z.Adnan Ademi; Hapi diskutimin për këtë pikë.

Kryesuesi i Kuvendit, z.Adnan Ademi; Konstatoj kuorumin prej 21 anëtarëve prezent në mbledhje.

*** Kuvendi i Komunës, unanimisht miratoi vendimin për ta nxjerrë në diskutim publik, Draft-Rregullo ren Komunale për procedurat dhe kriteret për zgjedhjen e Lauratëve të vitit në sport, për afatin prej 15 ditësh. Bartëse e procesit të diskutimit publik është Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport, në bashkëpunim me Zyrën për Informim.**

Pika 11

Draft-Strategjia e zhvillimit ekonomik të Komunës së Shtimes, Diskutim Publik)

Kryesuesi i Kuvendit, z.Adnan Ademi; Fjalën ja dha Kastriot Shabanit.

z.Kastriot Shabani, DZHE; Kjo do të shkojë në diskutim publik.

z.Përparim Ramusa; E shfrytëzojë rastin ta përshëndes dhe urojë për punën Kastriotin, jemi të shkojmë në diskutim publik.

znj.Adelina Beqaj; Kush e ka punuar këtë draft?

z.Kastriot Shabani, DZHE; Përgjegjësi i ka pasë grupi punues.

z.Besnik Seferi; Edhe ne e urojmë dhe e përgëzojmë Kastriotin për punën e bërë.

Kryesuesi i Kuvendit, z.Adnan Ademi; Konstatoj kuorumin prej 21 anëtarëve prezent në mbledhje.

*** Kuvendi i Komunës, unanimisht miratoi vendimin për ta nxjerrë në diskutim publik, Draft-Strategjinë e Zhvillimit Ekonomik Lokal 2024-2027 për afatin prej 15 ditësh. Bartëse e procesit të diskutimit publik është Drejtoria për Zhvillim Ekonomik, në bashkëpunim me Zyrën për Informim, dhe Komitetin për Politikë dhe Financa.**

Pika 12

Formimi i Grupit punues për hartimin e Planit të punës dhe orarit të mbledhjeve të Kuvendit për vitin 2024

Kryesuesi i Kuvendit, z.Adnan Ademi; Hapi diskutimin për këtë pikë.

znj.Adelina Beqaj; Nga PDK e kemi të propozuar Hamëz Tërshani.

z.Besnik Seferi; Ne propozojmë Sanije Sadik..

z.Kadri Emmini; Ne propozojmë Rrezartë Ramadani.

Kryesuesi i Kuvendit, z.Adnan Ademi; Konstatoj kuorumin prej 21 anëtarëve prezent në mbledhje.

*** Kuvendi i Komunës, unanimisht aprovoi Vendimin për formimin e Komisionit për hartimin e Planit të Punës së Kuvendit për vitin 2024, në këtë përbërje: Hamëz Tërshani, - (PDK) Sanije Sadiki, - (LVV), Rrezartë Ramadani, - (LDK).**

Pika 13

Propozim-Vendim për ndryshimin e vendimit të Kuvendit Npi-01/54 dt. 28.03.2022, për plotësimin e KPF me anëtarë të ri

Kryesuesi i Kuvendit, z.Adnan Ademi; Ministria na e ka kthyer këtë vendim edhe pse ne e kemi diskutuar që një kohë të gjatë.

z.Reshat Mujota; Unë jam zgjedhur dy herë dhe ju nuk më keni thirrur për mbledhje të KPF-së. Asnjëherë nuk keni thënë për shkakë të kuotës por se është i kundërligjshme si mundë të dilni kunder vetes. Në mbledhjen e VIII e diskutova me fillim dhe kam propozuar me u futë bashkë me Rexhen edhe kjo pikë për KPF-në. PDK-ja e ka lëshuar mbledhjen. Pozitat politike i dijmë me drejtor, por jo nuk bëhen votat me parime. Unë me një KPF nuk mundem me u bë vegël e askujt.

z.Kadri Emmini; U bë shumë gjatë mos funksionimi i KPF-së, unë kam pas thënë se shumica nuk ka mundësi me përcaktu numrin e naëtarëve në KPF sepse U.A e cakton saktësisht procedurën, kuota gjinore është obligim ligjor, duhet ta kompletojnë KPF-në ndryshe nuk bënë.

z.Reshat Mujota; Faleminderit për sqarimin nuk i takon partis demokratike plotësimi i kuotës, ka edhe vendime tjera që kemi marrë njëjtë. Unë nuk mujë me ndërru gjinin për një Komitet unë nuk jam kanë pengesë e Kuvendit asnjëherë.

z.Rexhep Gashi; Po lidhem te kjo pikë, ne e dimë se është bërë edhe një shkelje gjdo herë Kryesuesi i Kuvendit e përdorë votën e dyfishtë. Në dokument janë disa emra herë janë opinione e herë

dokumente të MAPL-së. Kadrija nuk tërheket prej fjalës e kam besimin, u kanë fjala me qu Mujoten në QKMF sepse ka qenë i sëmur.

z.Kastriot Shabani, DZHE; E vërtetë është ajo që e tha Reshati ne kemi fol dhe i kemi thënë se po mund ta bëjmë por legjitimitetin e cakton MAPL-ja. Atë që e kemi thënë i rrijmë mbrapa.

z.Përparim Ramusa; Fillimisht VV-ja e ka propozuar Rexhen. Pranone që është pazar ky. Njëherë duhet me shkarku e pastaj me zgjedhë antarin e ri të KPF-së.

z.Kadri Emini; Unë muj me propozu që propozimi me u largu e me votu Reshatin por nuk është e ligjshme.

z.Besnik Seferi; Mirë është që e kemi krijuar këtë unifikim, tash Përparimi e ka mundësinë e replikimit dhe diskutimit. Ideja ka qenë që të bashkohemi e ta bëjmë një punë më të mirë.

Kryesuesi i Kuvendit, z.Adnan Ademi; Lexoi rekomandimin e MAPL-së.

z.Reshat Mujota; Udhëzimin administrativ e kam përpara. Po habitem me ju, as nuk shitem as nuk blehem, nuk zhgënjena për punën që e kamë bërë. Nuk është meritokraci për 11 vota. Nuk jamë këtu për pjesën materiale. Me dorëheqjen e Dr.Ises unë ja lëshoj vendin anëtarit të ri në Komitetin e Shëndetësis. Unë prapë hy në vota se i kam 10 vota. Prapë keni me trokit derë më derë për vota. Ju pafsha me këtë fytyrë e me këtë nderë.

z.Përparim Ramusa; Isha shumë i kuartë MAPL-ja e ka kthyer rekomandimin me datë 06.07.2023, ofertën e keni bërë pas kësaj.

z.Hamëz Tërshani; Jam pro formimit të shumicës por qysh arritët me bë këtë shumicë. Gruja e kolegut është bërë drejtoreshë, ja qysh u bë shumica.

Kryesuesi i Kuvendit, z.Adnan Ademi; E kemi një propozim nga LVV-ja për anëtarë të KPF-së znj.Zejnije Velu.

Kryesuesi i Kuvendit, z.Adnan Ademi; Konstatoj kuorumin prej 21 anëtarëve prezent në mbledhjes.

*** Kuvendi i Komunës, me 11 vota “Për” me 10 vota “Kundër” dhe me 0 vota “Abstenim”** miratoi vendimin për plotësimin e KPF-së me anëtarin e re, znj.Zejnije Velu nga Shtimja.

Pika 14

Propozim-Vendim për ndryshimin e vendimit të Kuvendit Npi – 01/139 dt. 31.05.2022, për plotësimin e KASHPU me anëtarë të ri

Kryesuesi i Kuvendit, z.Adnan Ademi; Hapi diskutimin për këtë pikë.

z.Kadri Emini; A ka ndonë anëtarë që nuk është përfshirë në Komitete. Secili anëtarë është i përfshirë, i vetmi Artani nuk është përfshirë në ndonjë Komitet. Po besojë që duhet të formohet.

z.Hamëz Tërshani; Lexoi rekomandimin e MAPL-së.

z.Reshat Mujota; E thash edhe më herët unë zotri Idajet jap dorëheqje nga Komiteti për Shëndetësi. Unë mbajë parimet e mia, po e lëshojë vendin, plotësone edhe Komitetin për Shëndetësi sot.

z.Përparim Ramusa; Mbaj parimet po e lexojë prapë kur anëtari i Komitetit ndrron subjektin, anëtari i ri zgjidhet nga subjekti i njëjtë. Ne propozojmë që të shtyhet kjo pikë për mbledhjen e radhës.

z.Muhamet Ademaj; Unë propozojë që Artan Lubovci të zgjidhet anëtarë i Komitetit për Shërbime Publike.

Kryesuesi i Kuvendit, z.Adnan Ademi; Konstatoj kuorumin prej 21 anëtarëve prezent në mbledhje.

*** Kuvendi i Komunës, me 11 vota “Për” me 10 vota “Kundër” dhe me 0 vota “Abstenim”** miratoi vendimin për plotësimin e Komitetit për Ambient, Shërbime Publike dhe Urbanizëm me anëtarin e ri, z.Artan Lubovci nga Shtimja.

Kryesuesi i Kuvendit, z.Adnan Ademi; 10 minuta pauzë në ora 15:35h, vazhdojmë në ora 15:45h.

Propozim-Vendim për ndryshimin e vendimit Npi-01-149 dt 27.04.2023 të Komis. të Aksionarëve të KRM 'Pastërtia' Njësia në Shtime

Kryesuesi i Kuvendit, z.Adnan Ademi; Zotri Amrushu ka kërkuar fjalën për diqka, jashtë rendit të ditës.

z.Lumni Amrushu; Ju ftojë në drekën tradicionale që mbahet për herën e shtatë për dhurimin e gjakut në Pjetërshticë.

Kryesuesi i Kuvendit, z.Adnan Ademi; Do ta potencojmë në mbledhjen solemne nesër.

Kryetari, z.Qemajl Aliu; Ne jemi organizatorë dhe e kemi një Këshill Organizativ, ju lusim që ti përmbaheni agjendës të Këshillit duke u harmonizuar me vullnetin e përbashkët si pjesë insitucionale.

z.Lumni amrushu; Ky është aksion vullnetar i shtatë e prej që jeni ju në pushtet është i treti, ftesat i keni marrë ndërsa Këshilli është dashur me na thirrë neve për me u përfshi në agjendë. Nuk e di kur është bërë ai Këshill.

Kryetari, z.Qemajl Aliu; Kurgjo të keqe këtu nuk ka ti harmonizojmë oraret, në ora 11 nuk mund të marr pjesë sepse jam në Petrovë ku do të zbulohet Labidari i 3 Dëshmorëve. Gjaku nuk dhurohet për parti por për njerëzit në nevojë dhe humanitet.

Kryesuesi i Kuvendit, z.Adnan Ademi; Vazhdojmë me pikën e rendit të ditës. Te kjo pikë në KPF ka kaluar me shumicën e votave, hapi diskutimin për këtë pikë.

z.Kadri Emini; Qëllimi i ndryshimit të këtij vendimi është mos bashkëpunimi i Komisionit me institucionin siç është Komuna e cila është aksionare në K.R.M “Pastërtia” unë nuk e di sa mbledhje janë mbajtur. Jemi dakorduar me LVV-në që vendimi të ndryshohet tërësisht sepse është në interes të Kompanisë Publike, nuk jam kundër emrave që kanë qenë në vendim. I njejtë (Besnik Seferi) nuk është dashur me u shkarku sepse na ka mbajtur të informuar për punën e Kmpanisë.

z.Reshat Mujota; E tha Kadria që Komisioni nuk ka bashkëpunuar me Komunën. Komuna e ka shkëputur kontratën me K.R.M “Pastërtia”. Kadri sa herë e ke ngritur ti si shqetësim, sa herë ke kontribuar këtu, kjo është taktik politike. Besniku ka dhënë dorëheqje e ne e kemi votuar dorheqjen. Propozojë që ti hjekim 3 anëtarët e Komisionit. Kjo nuk është e drejtë më mirë thuaj i kemi bërë votat dhe jemi në rregull.

z.Besnik Seferi; Unë kam dhënë dorëheqje sepse nuk kam dashur me ra pre e dallaverave me vota. Kemi qenë 3 anëtarë dhe unë jam prapë anëtarë për të vetmen arsye se ka thënë ai i madhi Kryeministri Albin Kurti se “Mundesh por pastaj nuk mundesh”.

z.Reshat Mujota; Kamë shpresuar te ti, por nuk je ai Besniku i mëparëshm tash prapë ke me u bërë me një votë të PDK-së, unë prap të votojë. Nuk ka meritokraci këtu, Kryetari gjithëmon ka me qenë nën presion. Kanë filluar me u rritë apetitet.

z.Përparim Ramusa; Te ky propozim le ta kuptojnë qytetarët se krejt janë bërë për pazare, nuk është etike vetëm sa me ua dhënë nga 170 euro. Qysh kanë pasë me dhënë raporte Komisioni kur qe 3 muaj nuk kanë mbajtur mbledhje.

z.Rexhep Gashi; Unë nuk do të ja shkoqi hiq, si Kuvendi i matrapazllëqeve. Në fillim ja keni filluar që ta keqpërdorni qashtu që të mos hetoheni. Mjerim është në atë Kompani punon me vështërsi. Ju ja keni shkëput kontratën prej 40 mijë euro. Emërimi im ka qenë 27.04.2023 më ka ardhë vendimi pas dy muajve. I falenderojë ata votues që më kanë votuar. Pavarsisht kush zgjidhet nuk ka me mujt me bërë punë.

z.Asllan Beqaj; Po lidhem me K.R.M “Pastërtia” nëse ka qenë matrapazllëk, siq po thuhet nga Rexha hera e parë a është edhe tash. Sa herë keni diskutuar për grevat e atyre puntorëve as në Facebook nuk ke postuar asgjë asnjë lajm e leje më me u interesuar për kushtet e punës së tyre. Asnjë palë dorëza nuk i keni diskutuar me ua ble atyre punëtorëve, e as në buxhet nuk keni kërkuar ndihmë për këtë Kompani. Qe 3 muaj asnjë çështje nuk e keni ngritë. Kjo nuk shkon ashtu që kur të konvenon ty me ja bërë kështu e pastaj krejt ndryshe.

z.Rexhep Gashi; Raporti jepet një herë në vitë këto janë krejt matrapazllëqe.

z.Kadri Emini; Ne e kemi rishikimin e buxhetit dhe mundemi me i alokuar gjysmën e komunalive.

znj.Zejnije Velju; Propozojmë Besnik Seferin nga LVV-ja. Ne besojmë fuqishëm në punën e Besnikut.

z.Muhamet Ademaj; Ne si LDK-AKR e Propozojmë Besiana Rashitin nga Petrova si anëtare të Komisionit.

z.Asllan Beqaj; Sa i përket LVV-së ne nuk jemi të tillë dhe nuk ka matrapazllakë te ne. Po shihet që ne jemi unik në qëndrimet tona, prandaj ne kemi me kërk raport nga Besniku e jo me u shetit nëpër Evropë si ti e me ardhë këtu me thënë matrapazllëk.

z.Rexhep Gashi; Propozimet duhet me u dhënë si duhet qka po ju intereson juve agjenda ime, nëpër Evropë.

z.Përparim Ramusa; Unë propozojë me qitë në votim mos me shkarku Komisionin e mëparshëm.

z.Reshat Mujota; Rr dhe unë kërkoj që Komisioni mos me u shkarkua. E qka nëse unë e propozojë Kadri Emini në Komision.

z.Hamëz Tërshani; Kam propozim mos me pranë kandidaturën e Besnikut, sepse mund të ndryshojnë numrat edhe ta prishë Komisionin prapë.

z.Kadri Emini; E falenderoj Reshatin, jam i thirrur për me i votu ata që e bëjnë punën më mirë. Unë e tërheqi kandidaturën.

Kryesuesi i Kuvendit, z.Adnan Ademi; Konstatoj Kuorumin prej 20 anëtarëve prezent.

* **Kuvendi i Komunës, me 11 vota “Për” me 9 vota “Kundër” dhe me 0 vota “Abstenim” miratoi, vendimin për shkarkimin Komisionit Komunal të Aksionarëve për KRM “Pastërtia” SH.A - Njësia në Shtime, sipas vendimit të Kuvendit të Komunës së Shtimes Npi – 01/149 i datës: 27.04.2023.**

* **Kuvendi i Komunës, me 11 vota “Për” me 8 vota “Kundër” dhe me 1 vota “Abstenim” miratoi, vendimin për zgjedhjen e anëtarëve të Komisionit të Aksionarëve për Kompaninë Rajonale të Mbeturinave “Pastërtia” SH.A. Njësia në Shtime, si vijon:**

1. **Bedri Zeqiri, - Rr. “Nënë Tereza” Nr.40 Shtime, (i emëruar nga Kryetari i Komunës)**
2. **Besnik Seferi - Rr. “Qamëria” Nr.169 Lagja Pajtimit (i zgjedhur nga Kuvendi)**
3. **Besiana Rashiti - Rr.”Nazim Bakiu” Nr.60 Petrovë (e zgjedhur nga Kuvendi).**

Pika 16

Propozim-Vendim për faljen e 100 euro për Tatim-paguesit e komunës së Shtimes për vitin 2023.
(Pikë Shtesë)

Kryesuesi i Kuvendit, z.Adnan Ademi; Hapi diskutimin për këtë pikë. Meqenëse nuk ka diskutime atëher, Konstatoj Kuorumin prej 20 anëtarëve prezent në mbledhje.

***Kuvendi Komunës, unanimisht miratoi Vendimin për faljen e 100 (njëqind) euro nga tatimi në pronë, për vitin 2023 për të gjithë tatimpaguesit e Komunës së Shtimes.**

Kryesuesi i Kuvendit, z.Adnan Ademi; Pasi që diskutime të tjera nuk kishte Kryesuesi mbledhjen e Kuvendit e përfundoi në ora 16:45h.

Procesmbajtësi:
Idajet Rexhepi



Kryesuesi i Kuvendit
Adnan Ademi

